



RAPORTI GJASHTË MUJOR I PUNËS

JANAR-QERSHOR 2026

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Raport i punës për periudhën janar – qershor 2026

Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ushtron përgjegjësitë që i takojnë Komunës në përputhje me dispozitat ligjore, duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, si dhe Statuti i Komunës Nr. 1005, i datës 29.03.2017.

Ky raport paraqet aktivitetet dhe punët e realizuara gjatë periudhës **janar–qershor 2026** nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Në kuadër të kësaj drejtorie funksionojnë dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit;
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit janë pranuar gjithsej **173 kërkesa**, prej të cilave **157** në Sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit dhe **16** në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit. Gjatë kësaj periudhe janë zgjidhur **128 lëndë**.

Të hyrat buxhetore në DUPMM (janar–qershor)2022 – 2026

Viti	2022	2023	2024	2025	2026
Të hyra Janar- Qershor	6,343.17	13,601.06	23,531.33	22,307.45	39,120.11

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, zyrtarët e Sektorit të Urbanizmit dhe Planifikimit kanë qenë të angazhuar në lehtësimin e procedurave për pajisje me leje ndërtimi dhe në trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe investitorëve.

Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban, të gjitha kërkesat janë trajtuar brenda afateve ligjore. Janë lëshuar kushte ndërtimore dhe leje ndërtimi për objektet që janë në përputhje me planet urbanistike të miratuara nga Kuvendi Komunal dhe me Planin Zhvillimor Komunal në fuqi.

Për pajisjen me kushte ndërtimore dhe leje ndërtimi janë dorëzuar dokumentacioni përkatës, projektet ideore dhe projektet zbatuese, të cilat janë pranuar dhe kontrolluar nga zyrtarët përgjegjës. Gjithashtu janë lëshuar edhe pëlqimet përkatëse.

Kërkesat e shqyrtuara (janar–qershor 2026)

Janar- Qershor- 2026					
Kërkesat	Nr.total	Aprovuar	Refuzuar	Në shqyrtim	Hudhet
Leje ndërtimi	25	22	0	3	0
Leje përdorimi	4	4	0	0	0
Leje rrënimi	10	6	0	4	0
Kushte ndërmorre	50	36	0	11	3
Kërkesë	51	25	4	22	0
Vërtetim Urbanistik	14	8	2	3	1
Legalizim i objekteve	3	2	0	1	0
Gjithësej	157	103	6	44	4

Të hyrat (janar–qershor 2026)

Parallogaria	27546.29€
Vërtetim –Pelqim	985€
Legalizim	5420.58€
Totali i të hyrave	33951.87€

SEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

Në kuadër të Sektorit të Mbrojtjes së Mjedisit lëshohen leje mjedisore komunale dhe leje ujore komunale.

Kërkesat e shqyrtuara (janar–qershor 2026)

Janar - Qërshor 2026					
	Nr.total	Aprovuar	Refuzuar	Në shqyrtim	Hudhet
Leje mjedisore	16	13	2	1	0
Gjithësej	16	13	2	1	0
Totali i të hyrave				5168.24€	

HARTIMI I HARTËS ZONALE 2026–2034

Drafti i Hartës Zonale 2026–2034 ka marrë pëlqimin nga ministria për fillimin e procesit të shqyrtimit publik. Vendimi është miratuar edhe nga Kuvendi Komunal. Pas marrjes së konfirmimit të ligjshmërisë, drafti do t'i nënshtrohet shqyrtimit publik.

NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR NË QYTET

Sheshi Qendror është një nga projektet më të mëdha urbane të komunës gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore. Punimet në terren kanë vazhduar, megjithëse me intensitet më të ulët për shkak të situatës së krijuar nga procedurat përmbare.

NDËRTIMI I KULLËS NË RETIJË

Po vazhduar veshja me gur e objektit të kullës. Punimet e brendshme kanë përfunduar në tërësi, ndërsa po kryhen përgatitjet e fundit për finalizimin e projektit.

NDËRTIMI I KOLEKTORIT DHE RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT HOÇË E MADHE – BRESTOC – HOÇË e VOGËL– NAGAC– KRUSHË E MADHE

Operatori ekonomik është rikthyer në punishten e projektit dhe ka vazhduar punimet për ndërtimin e kolektorit. Pavarësisht vështirësive të shkaktuara nga procedurat përmbare, punimet janë duke vazhduar sipas dinamikës së planifikuar.

Drejtor
Albnor Mullabazi

